


Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi KKSB-të

Në vitin 2009, Këshillat Komunalë për Siguri në Bashkësi, mekanizma lokalë të sigurisë, u krijuan për të përmirësuar sigurinë dhe stabilitetin e komunitetit. KKSB-të përfshijnë përfaqësues të të gjitha bashkësive etnike dhe fetare që banojnë në komunë dhe një larmi të gjerë të aktorëve të komunitetit të cilët luajnë rol në prosperitetin afatgjatë të komunitetit. Ata duhet të takohen të paktën gjashtë herë në vit. Deri më sot, KKSB-të janë themeluar në 34 komuna. KKSB-të aplikojnë qasje gjithëpërfshirëse në përcaktimin e asaj se çfarë përfshin siguria e komunitetit dhe kush është përgjegjës për krijimin e një mjedisi të sigurt. Siguria e komuniteteve nuk është përgjegjësi vetëm e Policisë së Kosovës por edhe e zyrtarëve qeveritarë dhe shoqërisë civile dhe KKSB-të ofrojnë një forum të veçantë për t'i bashkuar këta aktorë.


Dokumentet kyçe që rregullojnë themelimin dhe mandatin e KKSB-ve janë Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB) nr. 27/2012 dhe Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL) nr. 03/2012 për këshillat komunalë për siguri në bashkësi.

Themelimi 2014–2017


KKSB-të me së paku një anëtarë grua që përfaqëson një komunitet



Komunat që rregullisht i kompensojnë anëtarët e KKSB-ve




Numri i KKSB-ve ku mungojnë përfaqësues të komuniteteve*



* Sipas nenit 4 të Udhëzimit Administrativ nr. 27/2012 MPB dhe Udhëzimit Administrativ nr. 03/2012 të MAPL për këshillat komunalë për siguri në bashkësi, çdo komunitet që banon në komunë duhet të ketë një përfaqësues në KKSB, pavarësisht madhësisë apo ndjenjës së përkatësisë etnike e popullatës. Kjo, megjithatë, është e vështirë të arrihet në praktikë për komunitetet me popullata shumë të vogla. Prandaj ky vlerësim gjithashtu aplikon një qasje më të butë - duke vlerësuar edhe pajtueshmërinë e përfaqësimit të komuniteteve kundrejt rezultateve të regjistrimit për komunitetet me më shumë se 50 anëtarë që jetojnë në komunë.


Performanca dhe funksionimi 2017

Numri i takimeve të mbajtura më 2016 dhe 2017




■ Janar – shtator 2017
 (pas zgjedhjeve lokale në tetor 2017 skadoi mandati i KKSB)
■ Janar – dhjetor 2016


Takimet e KKSB-ve ku u diskutuan incidente të sigurisë ose trendet dhe shqetësimet e përgjithshme të komuniteteve



KKSB-të që kanë miratuar plan të punës me aktivitete, që mëtojnë t'i adresojnë shqetësimet e sigurisë të komuniteteve në pakicë numerike



Numri i takimeve të KKSB-ve ku u diskutuan incidentet e sigurisë dhe trendet ose shqetësimet e përgjithshme të komuniteteve



Misioni i OSBE-së në Kosovë mbështet përmirësimin e institucioneve të mandatuara për trajtimin e shqetësimeve të sigurisë së komuniteteve. Për të ndihmuar në këtë drejtim, OSBE-ja monitoron rregullisht performancën e mekanizmave komunalë të mbrojtjes së komuniteteve. Këto letra informuese kanë për qëllim tu ofrojnë institucioneve përkatëse treguesit që mund t'ju ndihmojnë t'i identifikojnë zbrazëtirat dhe përmirësimin e pajtueshmërisë.